



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih  
Poslova / Ministry of Internal Affairs  
INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE  
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU  
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



HCDF

Në bashkëpunim me Projektin KSV 019  
Asistenca Teknike në kontekst të Integritimit  
implementuar nga ZKM dhe financuar nga  
Qeveria e Luksemburgut

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) mbështetur nga Projekti 'KSV/019 Asistenca Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian të Kosovës' bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike shpall:

### THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për ligjërues/trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

#### Trajnim për Trajnerë (TpT) Për Integrimin e të Huajve.

Programi do të përfshijë pjesën teorike dhe praktike lidhur me kornizën ndërkombëtare dhe vendore me fokus në zbatimin e legjislacionit të Kosovës për integrimin e të huajve përfshirë procedurat, kriteret në vendin tonë dhe standardet ndërkombëtare për trajtimin e të huajve.

Qëllimi i këtij programi është që të rritë kapacitetet e zyrtarëve dhe të krijoj nga ta një grup trajnerësh të cilët do të mund të bartin njohuritë të zyrtarët e institucioneve publike në lidhje me implementimin efektiv në praktikë të legjislacionit për integrimin e të huajve. Kandidatët që kalojnë me sukses programin e trajnimit, do të certifikohen në mënyrë që të mund të ofrojnë trajnime në këtë fushë.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Programi i trajnimit për trajner do të zgjasë shtatë (7) ditë. Programi do të mbahet tentativisht në mes të 7-15 Shkurt, 2023.

Vlerësimi i kandidatëve:

Në harmoni me Udhëzimin administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë përzgjedhjes dhe pas përfundimit të trajnimit. Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës në fushën adekuate;
- Përvoja në ofrimin e trajnimeve;
- Elementet tjera të meritës duke përfshirë hulumtimet dhe përvoja në fushën përkatëse.

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Aplikantët që do të rezultojnë të suksesshëm dhe në bashkëpunim me IKAP-in do të mund angazhohen si trajner në kuadër të trajnimeve të ofruara nga IKAP.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve është nga **11 janar 2023 deri me 25 janar 2023**. Pasi që numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar, përparësi kanë ata kandidatë që kanë përvojën e punës në fushën adekuate.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një letër motivimi (**deri në 250 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe (ne gjuhët tjera nuk do të shqyrtohet aplikacioni dhe as CV që nuk është në formën Europass) në email adresën: [Besart.Mulaj@rks-gov.net](mailto:Besart.Mulaj@rks-gov.net) , duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

**Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në Aplikacionin tuaj mund të kërkohen për verifikim.**